



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS  
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION  
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Nr. 221 Dt. 10.06.2015  
PRISHTINË • PRISTINA • PRIŠTINA

Ne bazë të nenit 32, 38 dhe 77 të Rregullores Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Propozimin Komesarit të Garave me Ref. 192 datë 27.5.2015, Komisioni Disiplinor me datë 04.6.2015 mori këtë:

## V E N D I M

- I. KB “Besa” nga Peja, përjashtohet nga garat për vitin garues në vijim 2014/15 dhe edicionin e ardhshëm 2015/16.
- II. Të gjitha rezultat e KB Besa të arritura nga xhiroja e XXII, regjistrohen me rezultat 2:0 në të mirë të kundërshtarëve.

### Arsyetim

Komisioni Disiplinor me datë **27.5.2015** ka pranuar Propozimin e Komesarit të Garave me Ref. Nr. 192 të datës **27.5.2015** për ngritje të procedurës disiplinore ndaj “KB Besa nga Peja dhe personit përgjegjës”, ku sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 32 të Rregullores Disiplinore të FBK zhvilloi procedurën disiplinore për çështjen në fjalë.

Komisioni disiplinor, në përbërje prej dy anëtarëve konstatoi se është arritur kuorumi dhe seancat e mbledhjes mund të vazhdojnë pa Kryetarin e këtij Komisioni, z. Fidan Hamiti i cili me datë 28.5.2015 është tërhequr nga ky rast nën arsyetimin se mund të ketë konflikt interesi.

Fillimisht u analizuan dhe shqyrtuan të gjitha provat dhe dëshmitë e ofruara nga Komesari i Garave të cilat lidhen me lëndën, si:

- Dëshmia Nr. 1 e datës 14 Mars 2015 për Regjistrimin e lojtarit të huaj **BALL GORDON** i cili është angazhuar në ndeshjen kampionale të xhiros XXII BESA VS PEJA më 15.Mars 2015, në shumë prej 605,00€;
- Dëshmia nr. 2 e dt. 21.Mars 2015 për Pagesën e gjobës për Gabimin teknik të **Beq Kovaqit** dhe borxhit ndaj FBK-së në shumë prej 120,00;
- Dëshmia nr. 3 e dt. 15.Prill për Pagesën e gjobës për Gabime Teknike të **Beq Kovaqit** dhe **Denis Kullashit**, në shumë prej 150,00€;
- Dëshmia nr. 4 e dt. 23. Maj.2015 për gjobë për mosjelljen e DVD (300,00€) dhe regjistrim e lojtarit Dorjan Zuberi (5,00), në shumë prej 305,00€
- Emailin e z. Kastriot Zuka, menaxher I zyrës – Prishtina Corporate Centre 01.6.2015

Komisioni Disiplinor, ka kërkuar nga përgjegjësit e KB Besa nga Peja me anë të email-it datë 30.5.2015, që të ofrojnë deklaratë me shkrim, dhe eventualisht dëshmi shtesë për rastin në fjalë e që me e datë 03.6.2015 nga përgjegjësi i këtij klubi z. Drilon Kukaj, sekretar i KB Besa ka pranuar deklaratën me shkrim me Ref. Nr. 205 datë 03.6.2015 të bashkëngjitura me një sërë dëshmish jo relevante për rastin (dëshmi të bashkëngjitur në dosje të kësaj lënde).

Komisioni Disiplinor analizoi me kujdes të gjitha faktet e paraqitura nga palët e përfshira në këtë çështje dhe konstatoi se, asnjë nga pagesat e prezantuara si të realizuara nga KB Besa nuk kanë



arritur në llogarinë e FBK-së, gjë të cilën e konfirmon email-i zyrtar i z. Kastriot Zuka, citojmë: *“Pergjigjja zyrtare e bankes TEB eshte qe keto pagesa jane te falsifikuara nga ana e klientit tuaj. Sipas Auditorit tone punetoret e bakes nuk jane ose nuk kane njohuri per keto pagesa.”*

E njëjta konfirmohet edhe nga përgjegjësit e KB Besa, e cila me datën 28.5.2015 ka paraqitur rastin në polici, e që Komisioni për hir të ruajtjes së sekretit profesional nuk e prezanton si dëshmi për shkak se është rast me të cilin duhet të merren organet kompetente të sigurisë dhe gjyqësisë.

Prezantimi i provave nga KB Besa për paraqitje të rastit në Polici ndaj personit të deleguar për realizimin e këtyre pagesave, nga Komisioni Disiplinor nuk mund të merren parasysh, pasi që ato paraqesin prova për çështje tjera administrative të cilat kanë të bëjnë me organizimin të brendshëm të KB Besa.

Komisioni Disiplinor, është i thirrur të vërtetojë dyshimet që lidhen me parregullsi që ndikojnë në mbarëvajtjen dhe zhvillimin e garave të basketbollit, ashtu si në këtë rast, nëse mjetet financiare kanë arritur në xhirollogarinë bankare të FBK të cilat lidhen me pagesën për regjistrimin e lojtarit, Ball Gordon, pagesat e gjobës për gabime teknike të Beqë Kovaqit dhe Denis Kullashit, si dhe pagesa për regjistrim e lojtarit Dorjan Zuberi.

Komisioni Disiplinor në përbërje prej, z. Nuredin Ibishit dhe z. Lulzim Fushticës me kujdes të veçantë bëri analizimin e të gjitha fakteve dhe provave të ofruara nga palët e përfshira, një nga një, veç e veç si dhe bëri krahasimin e tyre dhe për këtë çështje konsideron të arsyeshme shqiptimin e masës disiplinore si në pikën I dhe II të këtij Vendimi pasi që ka konstatuar se asnjë nga pagesat e prezantuara si të dyshimta nga Komisari i Garave nuk janë realizuar nga përgjegjësit e KB Besa nga Peja dhe në këtë rast është shkelur **Neni 77 i Rregullores Disiplinore ku thuhet: “Në qoftë se konstatohet se një lojtar është regjistruar me shënime të rrejshme ose dokumente të falsifikuara: Klubit ose Shkollës së basketbollit automatikisht i shlyhen të gjitha rezultatet e arritura, përjashtohet nga gara për vitin garues në vijim dhe edicionin e ardhshëm.”**

Andaj, në bazë të kësaj që u tha me sipër, komisioni njëzëri vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të paraqes ankes pranë Komisionit Arbitrar në afat prej 3 ditësh nga dita e marrjes së këtij vendimi.

**Vendimi t’i dërgohet:**

1. KB Besa – Pejë
2. Anëtarëve të KD,
3. Komesarit të Garave, dhe
4. Arkivit të FBK-së,

**Komisioni Disiplinor:**

1. Nuredin IBISHI, anëtar
2. Lulzim FUSHTICA, anëtar

